


**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM,
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT PROFESIONAL DY VJEÇAR NË
“TEKNOLOGJI E INSTALIMEVE ELEKTRIKE”
OFRUAR NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË TIRANËS**

Ekspertët i vlerësimit të jashtëm: Prof. Dr. Aida Spahiu
Dr. Lindita Dhamo



(Janar 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit profesional dy vjeçar në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Profesional I Tiranës
2	Departamenti që e ofron	Departamenti I Teknologjisë së Informacionit
3	Urdhëri/VKM i licencimit Vendimi I Bordit të Akreditimit	Urdher i MAS Nr 375, datë 25.07.2017 VBA Nr 20, datë 19.05.2017
4	Titulli i programit të studimit:	Program studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”
5	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet vetëm nga Institucioni
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 5
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017-2018
16	Numri total i studentëve për program studimi	22 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) është institucion i arsimit të lartë me orientim profesional, që synon të përgatisë profesionistë me aftësi praktike. KPT është themeluar në 26.08.2015 me Vendimin Nr. 699 të Këshillit të Ministrave dhe ofron arsim jouniversitar profesional dy vjeçar, ku studentët diplomohen me titullin “Teknik i Lartë”. Kolegji Profesional i Tiranës është pajisur me lejen e fillimit të aktivitetit me Urdhër nr. 426, datë 06/11/2015 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë institucioni të arsimit të lartë privat Kolegji Profesional i Tiranës”. KPT është akredituar si institucion i arsimit të lartë me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 66, datë 21.09.2017, proces i cili u realizua nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë e Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar. Akreditimi Institucional është i vlefshëm deri më 30.09.2022.

KPT përbëhet nga dy departamente: Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.

Departamenti Teknologjisë së Informacionit ofron programet dyvjeçare si mëposhtë:

1. Teknologji informacioni dhe komunikimi
2. Elektronikë
3. Database dhe Web design
4. Teknologji e instalimeve elektrike
5. Administrim Zyre

Departamenti i Elektro – Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ofron programet dyvjeçare si mëposhtë:

1. Elektro – mekanikë
2. Teknologji automjesh
3. Mekatronik
4. Teknologji ajrimi dhe kondicionimi
5. Gjeodezi
6. Teknologji ndërtimi
7. Teknologji Gazi

Programi i studimit “Teknologji e instalimeve elektrike” është hapur me Urdhër të MASH Nr 375, datë 25.07.2017 “Për hapjen e programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, në “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, të Kolegjit Profesional të Tiranës, mbështetur në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 20, datë 19.05.2017. Ky program ofrohet në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Elementët përbërës të këtij programi janë:

1. Program studimi 2 vjeçar me karakter profesional pas arsimit të mesëm në:

“Teknologji e Instalimeve Elektrike”

- | | |
|--|--------------------|
| 2. Kohëzgjatja (vite/semestra): | 2vite/4 semestra |
| 3. ECTS totale : | 120 kredite (ECTS) |
| 4. Forma e studimit: | me kohë të plotë |
| 5. Gjuha e programit të studimit | gjuha shqipe |
| 6. Diploma lëshohet vetëm nga KPT | |
| 7. Numri i studentëve për vit akademik parashikohet 20 – 100 studentë. | |
| 8. Niveli i diplomës në kuadër e Kornizës Shqiptare të kualifikimeve | Niveli 5. |

I gjithë vlerësimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), sipas rubrikave të mëposhteme, është mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit të hartuar dhe të dorëzuar nga Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) në ASCAL, në vizitën dy ditore të realizuar në ambjentet e KPT, si dhe në dokumentacionin plotësues të kërkuar nga GVJ gjatë vizitës.

GRUPI I VLERESIMIT TE JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Aida Spahiu
2. Dr. Lindita Dharmo

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Suela Kromidha, Specialiste në Sektorin e SPVC, ASCAL

Me shkresë nr 2 prot, datë 07.01.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft Raportit të vlerësimit të jashtëm", KPT është njoftuar për dërgimin e Draft RVJ nëpërmjet sistemit AMS më datë 04.01.2019.

Më datë 16.01.2019, KPT sjell komente në lidhje me këtë Draft. Grupi i vlerësimit të jashtëm i pa me kujdes të gjitha pikat ku institucioni kishte sjellë komente apo edhe sugjerime/shpjegime në lidhje me paragrafe të caktuara në Draft RVJ. GVJ mori në konsideratë disa prej këtyre komenteve duke bërë edhe ndryshimet përkatëse në Raportin përfundimtar. Në lidhje me sa më sipër, GVJ, bashkëngjitur këtij raporti ka vendosur pikat të cilat janë reflektuar dhe pikat të cilat nuk ndryshojnë në Raportin përfundimtar.

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Piesa përshkimore

Programi i studimit jouniversitar dy vjeçar "Teknologji e instalimeve elektrike", TIE, ka si qëllim kryesor edukimin akademik dhe trainimin profesional të studentëve në mënyrë që ato të integrohen sa më shpejtë në tregun e punës, mbështetur në Raportin e vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe nga vizita në institucion. Qëllime të tjera të këtij programi studimi janë të ndihmojë individët në rritjen e kualifikimit dhe aftësive profesionale, të sigurojë një bazë të mjaftueshme njohurish për të bërë të mundur transferimin e studentëve në programet e studimeve universitare etj.

Disa nga objektivat kryesore të programit të studimit janë: të përgatisë teknikë të lartë dhe profesionistë, të ofroj një program studimi me cilësi të lartë akademike, të realizoj një ndërthurje të praktikës me teorinë, të krijoj një ambient nxitës e mbështetës për studentët dhe stafin akademik.

Plani mësimor i programit të studimit përqëndrohet në lëndët e instalimeve elektrike në banesa dhe industri, matjet elektrike dhe instrumentat elektronikë, teknologji e ndriçimit, makina elektrike, PLC etj. Në planin mësimor përfshihen dhe lëndë të formimit bazë si matematikë, fizikë, gjuhë e huaj dhe bazat e informatikës. Në planin mësimor për vitin akademik 2018-2019 nuk është lënda e vizatimit teknik-autocad apo vizatimi dhe modelimi i skemave elektrike, plani mësimor 2018-2019 TIE, siç deklarohet në RVB f. 4 apo siç edhe GVJ ju tha gjatë vizitës në Institucion.

Mësimdhënia organizohet në formën e leksioneve, ushtrimeve dhe punëve laboratorike. Leksionet dhe ushtrimet janë shumë të rëndësishme për formimin teorik të studentëve ndërsa laboratorët për aplikimin praktikë të njohurive të marra në teori. Një rëndësi e veçantë i kushtohet lëndës së praktikës profesionale e cila zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë i programit të studimit TIE.

Prioritetet strategjike të Institucionit për të përmbushur objektivat e vëna dhe për programin e studimit TIE dhe të pasqyruara në Strategjia e Institucionit, evidenca 5, janë orientimi gjithnjë e më shumë drejt praktikës profesionale, ofrimi i një personeli akademik sa më cilësor ku të jenë kombinuar aftësitë teorike me ato praktike të tyre, krijimi i një infrastrukture sa më të mirë në mbështetje të procesit mësimor, bashkëpunimi me bizneset dhe Institucionet e tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, krijimi i mundësive për mësimin gjatë gjithë jetës.

Programi i studimit TIE është hapur për herë të parë në vitin akademik 2017-2018 me Urdherin Nr. 375, datë 25.07.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në këtë vit akademik janë regjistruar 11 studentë, ndërsa në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar për herë të parë 15 studentë. Gjithsej në këtë program studimi, viti i parë dhe viti i dytë, janë në total 22 studentë.

Numri i personelit akademik për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, që mbështet këtë program studimi ka ndryshuar në këto dy vite, për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 15 PAE/12 PAK ndërsa në vitin akademik 2018-2019 është 12 PAE/8 PAK, pasi tre personel efektiv ishin larguar. KPT po bën përpjekje për zëvendësimin e tyre. Personeli akademik ka kualifikimin e duhur për këtë program studimi në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 59, pika 6.

Niveli i diplomës në kuadër e Kornizës Shqiptare të kualifikimeve për këtë program studimi është niveli 5

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.</p> <p>Kriteri 2 Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.</p> <p>Kriteri 3 Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit.</p> <p>Kriteri 4 Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës</p> <p>Kriteri 5 Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen</p> <p>Kriteri 6 Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.</p>
<p><u>Vlerësimi sipas standardit 1:</u></p> <p>Kriteri 1. Programi i studimit jouniversitar me karakter profesional “Teknologji e instalimeve elektrike” ka trajtuar në rregulloren e studimit si objektiva kryesore pajisjen e studenteve me njohuri të thelluar teorike dhe praktike në fushën e sistemeve dhe aplikimeve elektrike për të përfutur përvojën profesionale të duhur për t’i bërë ato të suksesshëm në tregun e punës, aftësi për tu përshtatur me zhvillimet e teknologjisë në këtë fushë, njohuritë e duhura për të interpretuar problemet e ndryshme praktike, (neni 5, 10, i Rregullores studimit), Një rëndësi e vecantë në këtë program studimi i jepet praktikës profesionale, neni 11, për të cilën ka rregullore të veçantë, Rregullore për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë semestri i dytë e shtrirë në gjashtë javë me 210 orë në total. Praktika profesionale synon të nxisë zhvillimin personal dhe profesional të studentit si dhe synon të krijojë te studenti kulturën e punës, përqasjen ndaj punës, njohjen dhe organizimin dhe funksionimin e biznesit, si dhe të zhvillojë aftësitë ndërpersonale të komunikimit, të punës vetëm dhe të punës në grup. Praktika profesionale synon zbatimin në praktikë të teorisë së mësuar gjatë programit të studimit dhe të realizojë:</p> <p>1) Zhvillimin e kapaciteteve praktike të studentëve 2) Njohjen dhe kuptimin e terminologjisë, protokolleve, rregulloreve të punës dhe normave të etikës dhe sigurisë në punë; 3) Njohjen dhe kuptimin e përgjegjësive në punë; 4) Njohjen dhe ndërgjegjësimin për karrierën e ardhshme.</p> <p>Kriteri 2. Në rregulloren e programit të studimit, janë të shprehura qartë mundësitë e punësimit pas mbarimit të këtij programi studimi si në ndërmarrjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në entet e ndryshme private dhe shtetërore, si teknikë të lartë të instalimeve apo riparimeve elektrike në kompanitë që merren me instalimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike etj. Zyra e karrierës, informimit dhe mbështetjes së studentëve pranë KPT kryen ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve për të krijuar më pas ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritit për studentët në tregun e punës, bashkëpunon me departamentet e KPT për realizimin e këshillimit të duhur të studentëve për sa i përket karrierës, merr pjesë në organizimin e panairëve të punës me qëllimin e krijimit të kontakteve të reja në kuadër të marrëveshjeve të ndryshme mes institucioneve. Monitorimi i punësimit të studentëve, që do të mbarojnë këtë program studimi do të realizohet nga zyra e karrierës, mbështetjes dhe informimit të studentëve siç veprohet dhe për programet e tjera të studimit. Programi i studimit do të rishikohet në funksion të rezultateve të marra nga ky monitorim (reference material për zyrën e karrierës).</p>

Kriteri 3. Në planin mësimor janë disa lëndë, në mbështetje të zhvillimit të aftësive profesionale, si instalimet elektrike në banesa, instalimet elektrike në industri, PLC dhe praktika profesionale, numri i krediteve të të cilës është rritur nga 7 ECTS në 10 ECTS, në planin mësimor të vitit akademik 2018-2019.

Kriteri 4. Programi i studimit TIE parashikon kredite të përftuara gjatë punës, nëpërmjet lëndës praktika profesionale. Lënda praktika profesionale është planifikuar të kryhet në semestrin e dytë të viti të dytë, me 10 kredite. Kjo lëndë është e shtrirë vetëm në gjashtë javë, por me numrin e krediteve të rritura duhet të shtrihej të paktën në tetë javë. Duke patur parasysh karakterin profesional të këtij programi studimi, kjo lëndë duhet të ishte shtrirë në një semester, ose duhet të zhvillohej dhe në vitin e parë të studimit dhe në vitin e dytë. Në syllabusin e lëndës shkruhet që praktika profesionale do të zhvillohen në mjediset e Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT) ose mjediset e subjektit pritës. Gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me personelin akademik pamë që një pjesë e praktikës zhvillohej dhe në ambientet e institucionit kryesish me riparimin e pajisjeve të ndryshme, për programet e tjera të studimit. Në dosjen e paraqitur nga KPT ka marrëveshje me kompani shtetërore apo private në lidhje me kryerjen e praktikës nga studentët si Balfin grup, Impact Shpk, Electro-invest shpk, ECS dhe Birra Tirana.

Kriteri 5. Në programin e studimit, nga materiali i vënë në dispozicion, nuk ka të paraqitura, inisiativa specifike në lidhje me nxitjen e punësimit si për shembull mbështetja për sipërmarrjen.

Kriteri 6. Në materialet e paraqitura nga KPT ka marrëveshje bashkëpunimi midis KPT dhe kompanive të ndryshme shtetërore apo private.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit jouniversitar me karakter profesional “Teknologji e instalimeve elektrike” ka si objektivi kryesor pajisjen e studenteve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e sistemeve dhe aplikimeve elektrike për të përfutur përvojën profesionale të duhur për t’i bërë ato të suksesshëm në tregun e punës. Në planin mësimor ka lëndë, të cilat janë në mbështetje të zhvillimit të aftësive profesionale si: instalimet elektrike në banesa, instalimet elektrike në industri, PLC dhe praktika profesionale si dhe marrëveshje me kompani private për zhvillimin e praktikave profesionale. Në materialin e paraqitur është paraqitur plani i biznesit për këtë program studimi si dhe monitorimi i punësimit të studentëve do të realizohet nga zyra e karrierës, mbështetjes dhe informimit, që përfundojnë këtë program studimi. Inisiativa specifike në lidhje me nxitjen e punësimit duhet të shtohen dhe të paraqiten në materialet e dërguar.

2. Struktura akademike e Njesisë Bazë (përgjegjëse për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit TIE mbështetet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, i cili drejtohet nga Drejtuesi i departamentit dhe ka në varësi të tij tre laboratorët, laboratorin e elektronikës, i informatikës dhe ai i instalimeve elektrike. Në laboratorë nuk kishte personel ndihmës mësimor por vetë pedagogët e lëndëve përkatëse zhvillonin dhe laboratorët.

Numri i personelit akademik për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, që mbështet këtë program studimi ka ndryshuar në këto dy vite, për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 15 PAE/12 PAK ndërsa në vitin akademik 2018-2019 është 12 PAE/8 PAK, pasi tre personel efektiv ishin larguar. KPT po bën përpjekje për zëvendësimin e tyre. Personeli akademik ka kualifikimin e duhur për këtë program studimi në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 59, pika 6, pasi minimumi i kualifikimit është Master i Shkencave.

Personeli administrativ shërben dhe kombinon punën për të gjitha programet e studimit që ofton KPT.

Lëndët teorike bazë si dhe ato lëndë të programit të studimit, të cilat ofrohen dhe në programet e tjera të studimit të KPT, zhvillohen bashkë.

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (Departamenti/sectorët) për programin e studimit.

Departamenti ka si strukturë akademike Drejtuesin e Departamentit dhe prej tij varen tre laboratorë: laborator i elektronikës, i informatikës dhe ai i instalimeve elektrike. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk është i organizuar në grupe mësimore.

- ☑ Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Tabeln 1, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 1

Viti akademik	Stafi akademik i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit			
	Numri i PAE	Numri i PAK	Numri i Stafit të ftuar	Numri i Stafit administrativ
2015 - 2016	8	4	-	
2016 - 2017	12	12	-	
2017-2018	15	12	-	
2018-2019	12	8	-	7

Shenim: Për vitin akademik 2018-2019 numri i PAK është dhënë vetëm për semestrin e parë, informacion nga nga RVB, f. 13 dhe vizita në Institucion. Nuk ka informacion si do të jetë ky raport në semestrin e dytë.

Stafi administrativ punon për të gjithë institucionin. Ai përbëhet nga sekretarja e përgjithshme, dy sekretare mësimore nga një për secilin departament, një për zyrën e karrierës, një e zyrës së personelit akademik, administratori dhe një financë, përgjegjësi dhe specialisti i zyrës së IT, dy persona në bibliotekë dhe fotokopje, mirëmbajtësi i faqes pra gjithsej 12 persona. (Reference RVB, si dhe vizita në institucion.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik për programin e studimit TIE ka të gjithë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me ligjin 80/2015, minimumi i kualifikimit është Master i Shkencave. Politika, kriteret dhe procedurat e punësimit në KPT, përfshirë këtu edhe për programin e studimit të "Teknologji e instalimeve Elektrike" rregullohen sipas parshikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve rregulatore të KPT, sidomos Statusi, Rregullorja e KPT dhe Manuali i Burimeve Njerëzore. Rekrutimi i personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë është bërë në përputhje me nevojat për pedagogë, bazuar në planin mësimor si dhe ngarkesën mësimore të çdo lënde. Rekrutimet e realizuar janë dy tipe: me transferime brenda programeve të studimit që mbështet KPT dhe rekrutim i jashtëm, mbështetur mbi njohjet e specialistëve dhe pedagogëve të fushës, data bazave të ndryshme, njoftimeve të ndryshme në faqen e KPT etj. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve, janë treguesit e performancës të kandidatëve të tillë si:

- Të ketë së paku diplomë të nivelit Masterin Profesional.
- Cilësia dhe standartet e universitetit ku është diplomuar kandidati
- Aftësitë komunikuese dhe etika;
- Eksperienca e punësimit;
- Përvojë në mësimdhënie;
- Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë jo vetëm në aspektin teorik por edhe praktik;

Për vitin akademik 2017-2018, për programin e studimit TIE, raporti PAE/PAK ishte 15/12 ndërsa për vitin akademik 2018-2019 është 12/8, por ky raport i përket vetëm semestrin të parë.

Nuk mund të japim dot një vlerësim në lidhje me numrin *Personel akademik/Personel administrativ/student* pasi personeli administrativ u shërben të gjitha programeve të studimit që mbështet KPT.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (Tabela 2, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës).

Tabela 2

IAL: Kolegji Profesional i Tiranës - Departamenti I Teknologjisë së Informacionit							
PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Luan Karçanaj	Rektor	Prof. Dr.	1	Igli Tafa	Prof. Asc. Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Piro Cipo	Drejtues Departamenti	Prof. Dr.	2	Illir Shinko	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
3	Shpëtim Bozdo	Pedagog	Prof. Dr.	3	Nevila Xoxa	Msc.	Akademia e Shkencave
4	Saimir Yzeiri	Pedagog	MP	4	Erion Mali	Msc.	Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës
5	Petro Plasa	Pedagog	MND	5	Ardian Pollo	Msc.	Kompani Private
6	Engjëll Çiraku	Pedagog	Msc.	6	Boris Cfarku	Msc.	Universiteti Politeknik i Tiranës
7	Thimi Oço	Pedagog	Msc.	7	Ferit Arapi	Msc.	Administrator, Qendra e shërbimeve profesionale, Connect Academi
8	Ervin Suli	Pedagog	Msc.	8	Ersi Sala	Msc.	Hydro Power Plant
9	Besnik Sadaj	Pedagog	Msc.				
10	Hatixhe Bilibashi	Pedagog	Msc.				
11	Ervin Anastasi	Pedagog	Msc.				
12	Erison Ballasheni	Pedagog	Msc.				

Shënim: Per vitin akademik 2018-2019 numri i PAK është dhënë vetëm për semestrin e parë, informacion nga RVB, f. 13 dhe vizita në Institucion.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 3, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 3

Titulli	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	3	0	3/0
Profesorë të As.	0	1	0/1
Doktorë	0	1	0/1
Pedagogë (pa tituj)	9	6	9/6
Asistentë me Ma	0	0	0/0
Asistentë pa Ma	0	0	0/0
Instrukturë praktike	0	0	0/0
Personeli Administrativ			

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në kontratën individuale të punësimit, specifikohen termat dhe kushtet e punës sipas pozicionit përkatës dhe ajo është hartuar bazuar në parashikimet e legjislationet në fuqi. Kontrata përbënte:

- Emrat e punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- Data e fillimit të punës dhe periudha e punësimit të vazhdueshëm;
- Pozicioni i punës;
- Paga dhe intervalet në të cilat do të paguhet;
- Orët e punës;
- E drejta e lejeve;
- E drejta për raport mjeksor;
- Periudha e njoftimit për përfundimin e marrëdhënieve të punës;
- Kohëzgjatja e punësimit në rast se nuk është e pa caktuar duke e specifikuar datat e fillimit dhe përfundimit.

Në kontratën individuale të punës janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, të cilat duhen respektuar. Keto të drejta janë në përputhje me statusin.

Kontrata e PAE ishte pa afat ndërsa ajo e PAK ishte semestrale.

- Ngarkesa semestrale, vjetore etj

Gjatë vizitës në Institucion u kërkua dhe ngarkesa e lidhur me personelin akademik. Ngarkesa mësimore për PAE përcaktohet nga Rektorati dhe rregullohet në kontratën e punës. Mbështetur në kodin e punës, statutin dhe rregullore të KPT. Ndërsa për PAK nuk ka një përcaktim në lidhje me ngarkesën e tyre.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Gjatë Vizitës në institucion u kërkuan CV e personelit akademik PAE dhe PAK, të cilat u vendosën në site e ASCAL Në site duhet të ishin vendosur dhe dëshmitë e gradës/titullit për të gjithë personelin akademik PAE dhe PAK.

Gjatë vizitës në institucion u kërkua dhe dokumenta të tjera si: ngarkesa mësimore e lidhur me personelin akademik për vitet akademik 2017-2018, 2018-2019, pyetësi i vlerësimit të punës së pedagogut, rregullore e praktikës mësimore, relacione të praktikës, formularë të vlerësimit të praktikës, planet mësimore të programit të studimit duke filluar që nga ai i licensimit të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)</p> <p>Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.</p> <p>Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).</p>
<p>Vlerësimi sipas standardit 2:</p> <p>Kriteri 1. Në materialin e paraqitur nuk ka një studim tregu në lidhje me nevojat për këtë profesion, ku punëdhësit të ishin shprehur në lidhje me kërkesat e tyre thelbësore në lidhje me këtë profesion, pra cilat do të ishin njohuritë kryesore që duhet të merren nga studentët për ti bërë ato sa më të vlefshëm në tregun e punës. Zhvillimi i praktikës mësimore në semestrin e dytë, të vitit të dytë mund të jap një ndihmesë në</p>

këtë drejtim, për të njohur nga afër amjentin e punës, kulturën e punës së profesionit, problematikat e tij etj.

Kriteri 2. Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies: leksion, ushtrime, laborator dhe vlerësimi i të gjithë komponentëve të mësimdhënies janë të përfshira në programin e studimit të paraqitur.

Kriteri 3. Rezultatet e arritur nga ky program studimi do të monitorohen nga zyra e karrierës, mbështetjes dhe informimit të studentëve, ku kryesor është punësimi i studentëve që mbarojnë këtë program studimi, siç vepohet për programet e tjera të studimit të KPT.. Brezi i parë i studentëve për këtë program studimi diplomohet në vitin akademik 2018-2019. Kështu që plotësimi kriteri 3 i këtij standarti do të shihet në të ardhmen e programit të studimit.

Standardi 5: Stafi zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standarti mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Stafi mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Stafi ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjesshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimin të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

Vlerësimi sipas standardit 5:

Kriteri 1. Në informacionin e ofruar nga Institucioni nuk të dhëna nga specialistët e sektorit përkatës të punësimit. Në të jepen vetëm mundësitë e punësimit të studentëve, që e përfundojnë atë.

Kriteri 2. Stafi mësimdhënës është i kualifikuar dhe përgatit materialet mësimore në gjuhën shqipe, të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Gjithashtu salla e fotokopjes ishte në dispozicion të studentëve për shumëfishimin e materialeve mësimore dhe laboratorëve. Studentët kishin akses dhe në sistemin classter, ku u mundësohej informacioni i plotë në lidhje me programin e studimit, syllabuset, orarin mësimor etj.

Kriteri 3. Zyra e karrierës organizonte në muajin Mars vizita në shkolla të mesme, për të dhënë informacion në lidhje me këtë program studimi. Gjithashtu vizitat mësimore në kuadër të procesit mësimor dhe pjesmarrja në panairin "Study and Work" ndihmojnë në këtë drejtim. Duhet theksuar se duhet bërë më shumë në këtë drejtim pasi numri i të regjistruarve për herë të parë në këtë program studimi është i ulët, 11 për vitin akademik 2017-2018 dhe 15 për atë 2018-2019, kur numri minimal i parashikuar nga Bordi i Administrimit për këtë program studimi është 20 studentë.

Kriteri 4. Programi i studimit TIE është program studimi me kohë të plotë prandaj nuk ofron mundësinë e të mësuarit virtual.

Konkluzionet e GVJ:

Plotësimi i këtij standarti do të shihet në të ardhmen, pasi akoma nuk ka studentë të diplomuar për këtë program studimi.

Personeli akademik i programit të studimit është i kualifikuar dhe përgatit materialet në gjuhën shqipe, ambientet mbështetëse janë në ndihmë të studentëve dhe zyra e karrierës ofron mbështetje për studentët.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Kolegji profesional i Tiranës është i vendosur në mjediset e kompleksit “Xhura” në Rr. Xhanfise Keko në Tiranë. Mjediset e KPT janë mjedise të marra me qera nga Institucioni. Në këto mjedise ka salla për leksione, seminare, laboratore të teknologjisë së informacioni, bibliotekë, mjedis për fotokopje si dhe zyra për Rektorin, drejtuesit e departamenteve, sekretarinë, NJBC, zyrën e mbështetjes së studentëve etj. Programi i studimit Teknologji e Instalimeve Elektrike e mbështet zhvillimin e punëve laboratorike kryesisht në tre laboratorë: 1. Laboratori i Elektronikës, ku zhvillohen laboratorët për lëndët e qarqeve elektronike dhe matjeve elektrike; 2. Sallat e kompjuterave, ku kryhen laboratorë dhe mësim për lëndë të ndryshme; 3. Laboratori i instalimeve elektrike ku kryheshin laboratorët e instalimeve elektrike në banesa, dy poste pune dhe në industri me një post pune. Në këtë laborator do të kryhen dhe laboratorët për lëndën e makinave elektrike, semestri i dytë, viti i dytë, për këtë duhet të bëhen investime të mëtejshme pasi në situatën aktuale nuk mund të kryhen punët e laboratorit për këtë lëndë. Gjithashtu dhe laboratori i fizikës ishte në funksion të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera që zhvillohen në KPT. Në mbështetje të programit të studimit janë dhe biblioteka, që është modeste, me numër të paktë librash dhe i shërben të gjitha programeve të studimit, që ofrohen nga Institucioni si dhe mjedis për fotokopje, ku shumëfishoheshin materialet për laboratorët dhe detyrat e kursit. Në bibliotekë ishin dhe materialet mësimore të përgatitur nga pedagogët e KPT në gjuhën shqipe.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit (plotëso Tabelën 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Mjediset për Kolegjin (për programin e studimit)	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	5	510.05
Klasa për seminare	7	307.4
Salla për aktivitete promovuese		
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	4	284.8
Laboratorë për lëndët	6	310.8
Laboratorë informatike	4	238.6
Salla interneti		
Salla për bibliotekë	1	89.6
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	27.4
Zyrë informacioni për studentët		
Korridore/holle		
Mjedise sportive		
Mjedise shërbimi për të tretë	1	38.5
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore		
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj		
Nyje hidrosanitare për studentët	6	112.2
Etj....		
Norma m²/për student		3.73 m²/për student

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore		
Zyra për personelin akademik	6	163.07
Zyrë për financën	1	10
Zyrë për Njësinë e SBC	1	20
Salla për mbledhje		
Mjedis për stafin e shërbimit	5	134
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	1	22.2
Norma m²/për person		8.95 m²/për person

Shënim: Mbështetur në RVB, f. 19, si numër studentësh është marrë 514 studentë për vitin akademik 2017-2018. Këto mjedise shërbejnë për të gjithë studentët e institucionit. Për këtë program studimi janë 15 studentë në vitin e parë dhe 7 studentë në vitin e dytë.

Laboratorët e informatikës shërbenin dhe për realizimin e orëve të ushtrimeve për lëndë të ndryshme.

Tabela 4 është plotësuar mbështetur në të dhënat e RVB por nga vizita në Institucion pamë se praktikat lëndore/profesionale nuk kryheshin në salla të dedikuara por ato zhvilloheshin në laboratorë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Gjatë vizitës në KPT u panë regjistri i regjistrimit të studentëve, regjistrat mësimore, fletët e provimit etj.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Mbështetur nga të dhënat e marra nga RVB dhe nga vizita në institucion, KPT është institucion i arsimit të lartë me vetfinancim. Burimet financiare sigurohen nga tarifat e shkollimit të studentëve, tabela 5, ndërsa në vitet e ardhshme mendohet të sigurohen nga: 1) tarifat e shkollimit; 2) nga shërbimet që KPT ofron për të tretët; 3) financim nga ortakët e KPT; 4) nga donacionet prej sektorit privat/publik; 5) projektet e ndryshme dhe burime të tjera të ligjshme.

Kostoja për student mbështetur 191,965Lek, RVB, faqe. 19 ndërsa pagesa për këtë program studimi është 2200EUR, e dhënë e marrë nga vizita në institucion.

Funksionet administrative financiare dhe ekonomike realizohen nga zyra e financës dhe administratori. Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare mbahen në programin financiar Alpha duke respektuar standartet kombëtare të kontabilitetit, RVB faqe 20. Për të patur një gjykim më të qartë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare duhet që institucioni të jap pasqyrat financiare të bilancit për vitet financiar 2015, 2016, 2017.

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Tabela 5, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 5

Të ardhurat (në lekë) nga:	Viti 1 (2015)	Viti 2 (2016)	Viti 3 (2017)
Pushteti qendror			
Pushteti vendor			
Grantet për kërkim dhe kontratat			
Konsulencat, shërbimet			
Tarifat (regjistrim/shkollim/etj)	23%	100%	100%
Sponsorizimet			
Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm)			
Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj			
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	77%		
SHUMA	100%	100%	100%

Shënim: Referencë është RVB, f.19. Nuk ka informacion për vitin 2018.

Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit

Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit të studimit “Teknologji e Instalimeve Elektrike” mbështet 100% tek tarifa e shkollimit, tabela 5.

- Kosto e studimit/për student për një vit akademik

Kosto e studimit për një vit për këtë program studimi është 191,965Lek /vit, e dhënë e marrë nga RVB, faqe. 19.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Në Kolegjin Profesional të Tiranës është ngritur dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), detyrat e kompetencat e së cilës jepen në Statutin e KPT dhe Rregulloren e NjsBC. Kjo njësi ka për detyrë të bëjë vlerësimin dhe garantojë cilësinë e ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të KPT (Evidenca 4-Statuti i KPT). Institucioni KPT ka ngritur këtë strukturë prej 28 dhjetorit 2015, dhe ka krijuar kushtet për funksionimin e NjsBC me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike në KPT për sigurimin e cilësisë. NjsBC përbëhet nga pedagogë të departamenteve të KPT, një anëtar nga njësiti ndihmëse, një përfaqësues prej studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Në tabelën 6 jepen të dhëna për përbërjen e NjsBC. KPT e rregullon aktivitetin e NjsBC me “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NjsBC në KPT” (Evidenca 16). Në këtë rregullore detajohen kompetencat dhe detyrat e NjsBC, të cilat konsistojnë në:

- Vlerësimi, rishikimi dhe përmirësimi i programeve mësimore dhe syllabuseve. Në çdo fillim viti akademik, nga NjsBC bëhet kontrolli e rishikimi i syllabuseve në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit. Preokupacioni kryesor nga ana e NjsBC është eliminimi i përsëritjes së tematikave në lëndët e ngjashme dhe përshtatja e lëndës me nivelin e programit të studimit.
- Mbarëvajtja e aktivitetit akademik
- Monitorimi i vazhdueshëm i orareve të zhvillimit të orëve mësimore: leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore etj. Kontrollohen periodikisht edhe regjistrat, frekuentimi i studentëve, kontrollohet hartimi i tezave të provimit, zhvillimi dhe korigjimi i provimeve.
- Zhvillimi i procesit të vlerësimit të pedagogëve prej studentëve bëhet nën kujdesin e NjsBC, e cila harton pyetësorin për studentët dhe përpunon rezultatet, të cilat i paraqet në një raport çdo fund semestri.
- Monitorimi i procesit të provimeve përfundimtarëve të lëndëve dhe cilësia e korigjimit të tyre është një ndër aktivitetet e kësaj njësie me qëllim eliminimin e korigjimeve fiktive.
- Monitorimi i procesit të praktikave mësimore dhe cilësia e zhvillimit të tyre,
- Monitorimi i Sekretarisë mësimore në procesin e hedhjes së notave në Regjistrin përkatës.
- Monitorimi i mësimdhënies së pedagogëve të rinj nga pedagogët me më tepër përvojë bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Pedagogë me eksperiencë të autorizuar nga përgjegjësi i departamentit dhe një anëtar i NjsBC marrin pjesë në orë mësimi për të evidentuar problematikën në mësimdhënie me qëllim përmirësimin e saj.

Aktivitetin e saj NjsBC e pasqyron nëpërmjet planit vjetor të veprimit të saj si dhe raporteve që ajo harton. Një nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së NjsBC është zhvillimi i procesit të vlerësimit të pedagogëve (për çdo lëndë) prej studentëve, i cili zhvillohet në çdo fund semestri. NjsBC ka hartuar një pyetësor në lidhje me mësimdhënien dhe punën konkrete që bën secili pedagog për rritjen e rezultateve, dhe pyetjet kanë të bëjnë me: mënyrën si bëhet mësimi, a janë të qartë në shpjegim, a respektohet etika në komunikimin me studentët, a menaxhohet mirë prej pedagogut koha e vënë në dispozicion, kërkohet mendim për cilësinë e temave mësimore dhe ndërthurjen e tyre etj. Rezultatet e pyetësorëve përmbledhen në formë tabelore dhe iu bëhen të ditur Departamenteve me qëllim përmirësimin e mësimdhënies në të ardhmen ose evidentojnë praktikatat e mira si shembull për t'u ndjekur.

NjsBC ndjek edhe trajnimin e stafit të pedagogëve në KPT. Në Evidencën 24- Trajnime nga POLYTECH, jepet lista e trajnimeve me tematika të ndryshme e ndarë sipas lëndëve dhe pedagogëve përkatës.

Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet edhe nëpërmjet tutoriateve dhe këshillimit akademik me studentët, mbi bazën e një orari të bërë publik çdo fillim semestri , me oraret e përcaktuara, pedagogun përgjegjës dhe sallën e takimit për çdo javë (Evidenca 13- Tutoriatet dhe Këshillimi Akademik). Problematika e ngritur në tutoriate adresohet më pas në strukturat e KPT me qëllim zgjidhjen e problemeve që bëjnë prezente studentët.

Tabela 6

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Antoneta Deda	Kryetare	Dhjetor 2016 e në vazhdim
2	Ervin Suli	Anëtar	Dhjetor 2015 e në vazhdim
3	Teuta Halilaj	Anëtar	Dhjetor 2015 e në vazhdim
4	Jola Osmenaj	Anëtar	Dhjetor 2016 e në vazhdim
5	Beniamin Disha	Përfaqësues i studentëve	Dhjetor 2017 e në vazhdim
6	Odeta Cati	Ekspert i jashtëm	Dhjetor 2015 e në vazhdim

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC si:

- NJSBC kryen anketime me studentët e programit të studimit në çdo fund semestri dhe për çdo pedagog lënde, maksimumi dy në vit.
- Numri i studentëve të anketuar varion nga lënda dhe numri i programeve të studimit ku ajo zhvillohet, këto anketime janë kryer për programet e tjera të studimit.
- Rezultatet e të gjitha anketimeve përpunohen dhe përmbledhen në formë tabelore shoqëruar me përshkrimin e problemeve që kanë dalë, raporti i vënë në dispozicion faqe e ascal është për programet e tjera të studimit, por për pedagogët që japin mësim dhe në këtë program studimi.
- Hapat e mëtejshëm që ndiqen kanë të bëjnë me bërjen me dije të departamenteve dhe stafit të pedagogëve me problematikat, për programin TIE ishte bërë reduktimi i krediteve për lëndët e matematikës dhe fizikës.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi

Përgjegjësitë kryesore në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi i mban Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, por në punën e saj ajo ndihmohet nga e gjithë struktura e KPT. Kjo njësi është ndërtuar me përbërje nga stafi akademik, me ekspert të jashtëm dhe përfaqësues nga studentët, për të mundësuar një vetvlerësim real e të paanshëm. Nga institucioni, kësaj njësie i është dhënë e drejta të ketë akses në të gjitha veprimtaritë e dokumentacionin përkatës. Nga ana tjetër departamentet bëjnë përpjekje që rezultatet e vetvlerësimit prej anketimit të përdoren për ndërtimin e politikave nxitëse për përmirësimin e mësimdhënies

Vetvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetvlerësimet e kryera janë periodike, në çdo fund semestri, dhe bëhet për të gjithë pedagogët. Studentëve u kërkohet të shprehen për pyetje që kanë të bëjnë me mësimdhënien, komunikimin etik me studentin, harmonizimi i lëndëve dhe përfitimin prej programit të studimit. Gjithashtu, për çdo pedagog, studentët kanë mundësi të shprehin edhe komentet e tyre nëse kanë. Rezultatet e anketimeve përmbledhen dhe departamenteve iu bëhet me dije problematika që del për stafin e programit të studimit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetvlerësimeve periodike

KPT bën përpjekje për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet ndjekjes së politikave të ndryshme që kryesisht mbështeten mbi bazën e vetvlerësimeve periodike (rezultati i anketimit periodik të studentëve për gjithë stafin akademik), por edhe duke zhvilluar trajnime për stafin në lidhje me pajisjet e reja laboratorike. Një

aspekt tjetër i punës së kësaj njësie është kontrolli i vazhdueshëm i korigjimit të provimeve, i plotësimit të regjistrave etj. Nga ana e kryetares së NJSBC u pranua se gjatë këtyre kontrolleve kishin hasur problematika (jo të shpeshta) në lidhje me korigjimin fiktiv të provimeve, për të cilën është mbajtur qëndrim nga Departamenti. Kjo është një praktikë pozitive e NJSBC, e cila ndihmon në identifikimin e problematikave dhe përmirësimin e tyre.

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Për Programin e Studimit “Teknologjia e Instalimeve Elektrike” që mbulon Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk ka rezultate auditimi dhe vlerësime të jashtme të mëparshme, sepse viti akademik aktual është viti i dytë i veprimtarisë së tij.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Dokumentacioni që u mor në KPT gjatë vizitës në institucion ka të bëjë me formularin që NJSBC e KPT përdor për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Kolegji Profesional i Tiranës për programin e studimit Teknologjia e Instalimeve Elektrike TIE ka hartuar planin mësimor në funksion të objektivave dhe qëllimit të vendosur në hapjen e tij. Ky program studimi ka 120 ETCS dhe zhvillohet në dy vite akademike me 4 semestra dhe 15 javë mësimore çdo semestër. Java e fundit mësimore e semestrit i përket provimit përfundimtar të lëndës. Ky program studimi është jouniversitar dhe si i tillë i përket nivelit 5 të kualifikimeve në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Në dispozicion të GVJ u vendosën 3 plane mësimore për TIE, planin mësimor të liçensimit të programit të studimit TIE dhe dy plane mësimore të tjera, një për vitin akademik 2017-2018 (vit që ky program studimi ka të regjistruarit e parë) dhe një plan mësimor për vitin akademik 2018-2019. Vihet re se plani mësimor i liçensimit ka pwsuar shumë ndryshime krahasuar me planet e tjera mësimore, gjë që nuk është e justifikueshme, pasi si program i ri ka nevojë për kohën e vet të konsolidimit. Nuk mund të ndryshohet plani mësimor pa u vënë në funksionim, në mënyrë që të shihen problematikat që sjell. Dy programet e tjera për dy vitet e tjera akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 janë me ndryshime jothelbësore, kryesisht zhvendosje lëndësh për harmonizim të marrjes së dijeve. Në tabelat më poshtë tregohen planet mësimore si dhe ndryshimet që ka plani mësimor 2018-2019 me planin e liçensimit.

Plani mësimor për programin e studimit Teknologjia e Instalimeve elektrike për vitin akademik 2017-2018 jepet në tabelën 7:

Tabela 7

Viti I/(Viti II) Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë /javë	Orë mësimore															Provime
				Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë			Orë në auditor	P. e Pavarur	Gjithsej	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				
1	Bazat e Informatikës	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
2	Bazat teorike të qarqeve elektronike	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
3	Fizikë e përgjithshme	I	5	3.9	2	14	36	2	24	26	1	21	4				59	66	125
4	Instalimet elektrike në banesa	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
5	Matematikë	I	4	2.5	2	14	36	2	24	26	-	-					38	62	100
6	Anglisht	I	4	3.2	2	-	50	2	48	2	-	-					48	52	100
7	Impiante elektrike	II	5	3.6	3	21	54	1	12	13	1	21	4				54	71	125
8	Matje elektrike e instrumenta elektronike	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
9	Furnizimi me energji elektrike i ndërrmarjeve	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
10	Instalimet elektrike në industri	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
11	Sisteme elektronike digitale	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
12	Makina elektrike	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
13	Cilësia, normat dhe teknika e sigurimit	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
14	Elemente të qarqeve elektrike 1 dhe 3fazore	III	7	4.9	4	28	72	2	24	26	1	21	4				73	102	175
15	Teknologji e ndricimit/ Kontroll automatik	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
16	Elektronikë Industriale	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
17	Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
18	PLC dhe rrjetat me to	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
19	Praktika profesionale	IV	10	35										10	210	40	210	40	250
20	Tema/provim formimi	IV	7														12	163	175
	Totali		120																

Plani mësimor për programin e studimit Teknologjia e Instalimeve elektrike për vitin akademik 2018-2019 jepet në tabelën 7.1:

Tabela 7.1

Viti I/(Viti II)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore															Provime			
				Orë në javë			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë				Orë në auditor	P. e Pavarur	Gjithsej
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				
																				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur
1	Bazat e Informatikës	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
2	Bazat teorike të qarqeve elektronike	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
3	Fizikë e përgjithshme	I	5	3.9	2	14	36	2	24	26	1	21	4				59	66	125			
4	Instalimet elektrike në banesa	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
5	Matematikë	I	4	2.5	2	14	36	2	24	26	-	-	-				38	62	100			
6	Anglisht 1	I	2	1.6	-	-	-	2	24	26	-	-	-				24	26	50			
7	Anglisht 2	II	2	1.6	-	-	-	2	24	26	-	-	-				24	26	50			
8	Impiante elektrike	II	5	3.6	3	21	54	1	12	13	1	21	4				54	71	125			
9	Matje elektrike e instrumenta elektronike	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
10	Furnizimi me energji elektrike i ndërrmarjeve	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
11	Instalimet elektrike në industri	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
12	Sisteme elektronike digjitale	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
13	PLC dhe rrjetat me to	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
14	Cilësia, normat dhe teknika e sigurimit	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
15	Elemente të qarqeve elektrike 1 dhe 3fazore	III	7	4.9	4	28	72	2	24	26	1	21	4				73	102	175			
16	Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
17	Qarqe të elektronikës së fuqisë	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
18	Teknologji e ndricimit/ Kontroll automatik	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
19	Makina elektrike	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150			
20	Praktika profesionale	IV	10	35										10	210	40	210	40	250			
21	Tema/provim formimi	IV	7														12	163	175			
	Totale		120																			

Nga krahasimi i planeve mësimore për programin e studimit Teknologjia e Instalimeve Elektrike, për dy vitet e para të zbatimit të tij 2017-2018 dhe 2018-2019, duket qartë që ndryshimet janë të pakta, kryesisht zhvendosje në semestra dhe ndarja e lëndës Anglisht në 2 pjesë, 2 ECTS në semestrin e I, viti i parë dhe 2 ECTS në semestrin e II, viti i parë, pa ndryshime në numrin total të krediteve.

Nëse krahasohet plani mësimor i vitit akademik aktual, 2018-2019, me planin mësimor të licencimit të programit të studimit TIE, ndryshimet janë të shumta: heqje lëndësh, ndryshime në emërtim, ndryshime kreditesh si dhe zhvendosje të tyre. Detaje të hollësishme në lidhje me këto ndryshime pasqyrohen në tabelën 9.

- Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit (Tabela 8, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 8

Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Lëndë bazë : në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Matematikë	4	9 (7.5%)
	Fizikë e përgjithshme	5	
Lëndë karakterizuese: në disiplina të formimit karakterizues (B)	Bazat Teorike të qarqeve elektronike	6	60 (50%)
	Instalimet elektrike në banesa	6	
	Impiante elektrike	5	
	Matje dhe instrumente elektronike	6	
	Furnizimi me en. elektrike i ndërmarjeve	6	
	Instalime elektrike në industri	6	
	Sisteme elektronike digitale	6	
	Makina elektrike	6	
	Cilësi, normat dhe teknika e sigurimit	6	
	Elemente të qarqeve elektrike 1 e 3fazore	7	
	Lëndë ndërdisiplinore/integruese: në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	Teknologji ndricimi/Kontroll automatik	
Qarqe të Elektronikës së Fuqisë		6	
Shpërndarje dhe përdorim i en. elektrike		6	
PLC dhe rrjetat me to		6	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)			
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Anglisht	4	20 (16.7%)
	Bazat e informatikës	6	
	Praktikë profesionale	10	
Provimi përfundimtar (F)	Diplome/Provimi formimi	7	7 (5.8%)

Plani mësimor për Programin e studimit Teknologjia e Instalimeve Elektrike është i shoqëruar me Syllabuset për çdo lëndë, ku janë të pasqyruara këto elementë:

- Emërtimi i lëndës ose modulit
- Semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën. Ka një mospërputhje për lëndën “Instalimet Elektrike në banesa” ku në planin mësimor lidhur me personelin figurojnë pedagogët I.Shinko dhe E.Anastasi, ndërsa syllabusi ka pedagog lënde E. Mali. Mund të jetë lapsus.
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Syllabuset shprehin se cilat janë njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë
- Syllabuset përmbajnë temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik. Përgjithsisht janë përshkruar temat e leksioneve ndërsa tematika e seminareve/ushtimeve nuk janë përshkruar pasi u referohen tematikave të leksioneve.

Përsa i takon laboratoreve, në katër lëndë të formimit profesional tematika e laboratoreve nuk është përshkruar. Mjaftohen vetëm me fjalinë që zhvillohen 7 punë laboratorit me nga 3 orë seicila, por nuk janë treguar temat e laboratorëve që do të zhvillohen.

- 1) Cilësia, normativat dhe teknika e sigurimit,
- 2) Elemente të qarqeve elektrike një dhe trefazore
- 3) Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike
- 4) Teknologjia e ndriçimit

- Në syllabuse tregohen kreditet që ka lënda dhe shpërndarja e tyre leksion/ushtime/laborator, ngarkesa në orë në auditor por nuk shprehet ngarkesa në orë jashtë auditorit. Lëndët Teknologji ndriçimi dhe Kontrolli Automatik, janë lëndë me zgjedhje me 6 ETCS gjithsej, prandaj syllabuset janë të veçanta për çdo lëndë të modulit, me 6 ETCS seicila.

- Në syllabus përshkruhet format e vlerësimit të studentëve.
- Përshkruhen detyrimet e studentit për lëndën.
- Syllabuset kanë të përshkruar literaturën e detyruar ose bazë, e cila është në gjuhën shqipe, literaturë të rekomanduar dhe ndihmëse, e cila është në shqip ose anglisht.

Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore

Në përgjithësi syllabuset janë përgatitur si duhet por ka lëndë të karakterit profesional si:

- 1) Makinat Elektrike,
- 2) Instalimet elektrike në industri,
- 3) Elemente të qarqeve elektrike një dhe tre fazore etj,

ku sasia e orëve në dispozicion për një temë të caktuar duket e pamjaftueshme për të dhënë qartë konceptin.

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Tabela 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës).

Ndryshimet në planin mësimor për vitin akademik 2018-2019, krahasuar me planin mësimor të licensimit për programin e studimit TIE për vitin akademik 2016-2017 tregohen në Tabelën 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës

Tabela 9

Viti I/Viti II Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															Provimet
				Leksione			Seminare			Laboraor			Praktikë			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	<i>Fizikë e përgjithshme</i>	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Fizikë e përgjithshme	I	5	3.9	2	14	36	2	24	26	1	21	4				59	66	125
2	<i>Matematikë</i>	I	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Matematikë	I	4	2.5	2	14	36	2	24	26	-	-	-				38	62	100
3	<i>Anglisht</i>	II	5	3	3	21	54	2	24	26	-	-	-				45	80	125
	Anglisht 1	I	2	1.6	-	-	-	2	24	26	-	-	-				24	26	50
	Anglisht 2	II	2	1.6	-	-	-	2	24	26	-	-	-				24	26	50
4	<i>Matje elektrike</i>	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Matje elektrike e instrumenta elektronike	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
5	<i>Elemente të qarqeve elektrike një e trefazore</i>	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Elemente të qarqeve elektrike një e trefazore	III	7	4.9	4	28	72	2	24	26	1	21	4				73	102	175
6	<i>Teknologji ndricimi/PLC dhe rrjetat me to</i>	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150

	Teknologji ndricimi/Kontr oll automatik	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
7	Cilësia , normativa, legjislacioni teknik	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Cilësia , normativat dhe teknika e sigurimit	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
8	Teknikë sigurimi dhe tokëzimi mbrojtës	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	PLC dhe rrejtat me to	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
9	Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
10	Impiante elektrike	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Impiante elektrike	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
11	Makina elektrike	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Makina elektrike	IV	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
12	Furnizimi me energji elektrike i ndërmarjeve	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Furnizimi me energji elektrike i ndërmarjeve	II	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
13	Elektronikë industriale	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
	Qarqe të elektronikës së fuqisë	III	6	4.4	3	21	54	2	24	26	1	21	4				66	84	150
14	Praktika profesionale	IV	7	23.3										7	140	35	140	35	175
	Praktika profesionale	IV	10	35										10	210	40	210	40	250
15	Tema /provim formimi	IV	6														12	138	150
	Tema /provim formimi	IV	7														12	163	175
Ndryshime në total																			

Shënim: Me shkronja kursive dhe në rreshtin e parë janë shënuar lëndët dhe ndarja e tyre sipas planit mësimor të licensimit ndërsa me shkrim normal janë lëndët dhe ndarja e tyre sipas planit mësimor për vitin akademik 2018-2019.

Në këtë tabelë janë paraqitur të gjitha tipet e ndryshimeve që kanë planet mësimore në kohën e liçensimit të programit të studimit me planin mësimor në vitin akademik aktual 2018-2019.

Ka gjithsej në total 15 ndryshime, të cilat janë shpjeguar më poshtë:

- a) 4 lëndë kanë ndryshime të numrit të krediteve (Tema/Diploma, Praktika profesionale, Matematika, Fizika e përgjithshme)
- b) 1 lëndë ka ndarje në 2 semestra (Anglisht)
- c) 6 lëndë kanë ndryshime në semestrin kur zhvillohet lënda.
- d) Ka 2 lëndë që kanë ndryshuar emrin pa ndryshuar kreditet (Matjet elektrike dhe instrumentat elektronike, Qarqet e elektronikës së fuqisë)
- e) Ka 2 lëndë që janë riorganizuar (Cilësia, normativat e teknika e sigurimit, dhe PLC e rrjetat me to)

Sugjerimi që do ti jepnim hartuesve të planit mësimor është që lënda e qarqeve një fazore dhe trefazore të zhvillohej para lëndës së instalimeve elektrike në banesa, pra që në semestrin e parë dhe jo në të tretin. Mostrajtimi i kësaj lënde para lëndës së instalimeve elektrike në banesa sjell vështërsi tek studentët pasi në instalimet në banesa hasen qarqet njëfazore ndërsa në instalimet në industri ato trefazore.

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik për vitin akademik 2018-2019, për semestrin e parë) është si në Tabelën 10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës.

Tabela 10

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët Përgjegjës	Titulli/grada Kualifikimi	Departamenti ku është me kohë të plotë	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1 Bazat e Informatikës	Nevila Xoxa	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK
2 Bazat teorike të qarqeve elektronike	Piro Cipo Saimir Yzeiri Besnik Sadaj	Prof.Dr Msc. Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAE
3 Fizikë e përgjithshme	Antoneta Deda Teuta Halilaj	Prof.Dr Msc	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	59	PAE
4 Instalimet elektrike në banesa	Ilir Shinko Ervin Anastasi	Dr. Msc	Teknologji Informacioni	66	PAK PAE
5 Matematikë	Shpëtim Bozdo Ervin Suli	Prof.Dr Msc	Teknologji Informacioni	38	PAE
6 Anglisht 1	Petro Plasa	MND	Teknologji Informacioni	24	PAE
7 Anglisht 2	Petro Plasa	MND	Teknologji Informacioni	24	PAE
8 Impiante elektrike	Boris Cfarku	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK
9 Matje elektrike e instrumenta elektronike	Jakup Agalliu Thimi Oco	Prof.Dr Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK PAE
10 Furnizimi me energji elektrike i ndërrmarjeve	Erion Mali Besnik Sadaj	Msc. Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK PAE
11 Instalimet elektrike në industri	Dritan Karriqi	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAE
12 Sisteme elektronike digjitale	Luan Karcanaj, Saimir Yzeiri Engjell Ciraku	Prof.Dr Msc. Msc	Teknologji Informacioni	66	PAE
13 PLC dhe rrjetat me to	Ilir Shinko	Dr.	Teknologji Informacioni	66	PAK
14 Cilësia,normat dhe teknika e sigurimit	Boris Cfarku	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK

15	Elemente të qarqeve elektrike 1 dhe 3fazore	Ersi Salaj	Msc.	Teknologji Informacioni	73	PAK
16	Shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike	Boris Cfaraku	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK
17	Qarqe të elektronikës së fuqisë	Piro Cipo Besnik Sadaj	Prof.Dr Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAE PAK
18	Teknologji e ndricimit/ Kontroll automatik	Piro Cipo Erion Mali	Prof.Dr Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAE PAK
19	Makina elektrike	Ersi Salaj	Msc.	Teknologji Informacioni	66	PAK
20	Praktika profesionale					
21	Tema/provim formimi					

Kjo tabelë tregon qartë se nga totali i 1142 ore ngarkesë mësimore, 634 orë ose 55.51% realizohen nga PAK dhe 508 orë ose 44.49% janë realizuar nga PAE. Ky raport duhet të ishte minimumi 70% nga PAE, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Nga stafi që zhvillon lëndët e këtij programi studimi, 4 janë me tituj e grada (3 profesorë dhe 1 doktor) ndërsa pjesa tjetër e stafit janë Msc.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Gjatë vizitës në KPT u kërkuan disa dokumente si: Rregullorja e praktikës mësimore, formularët e vlerësimit të praktikës nga mbikëqyrsi i praktikës në kompaninë ku realizohet ajo, nga pedagogu i ngarkuar me ndjekjen e praktikës, shembull i materialit të praktikës nga studenti, CV-të e stafit akademik efektiv dhe me kontratë, një model diplome për këtë program studimi, aktiviteti i zyrës së këshillimit të karrierës, planet mesimorë gjatë licensimit, për vitin akademik 2017-2018, për vitin akademik 2018-2019, planet mësimorë të lidhura me ngarkesën e stafit akademik, të cilat u vendosën më vonë në faqen e ASCAL- dosja e akreditimit për KPT.

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.
Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë: Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Suplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionalë) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit. Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor. Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve. Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +). Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.

Vlerësimi sipas standardit 6:

Kriteri 1. Programi i studimit TIE është në përputhje me marrëveshjen e Bolonjës dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe KShK.

Kriteri 2. Niveli 5 i kualifikimit merr diplomë profesionale jouniversitare DPJ (me fushën përkatëse) të shoqëruar me listë notash, nuk ka detyrim suplementin e diplomës.

Kriteri 3. Studentët që regjistrohen në këtë program studimi kanë fituar një diplomë të nivelit 4 të kualifikimeve (shkolla të mesme të përgjithshme ose shkolla të mesme profesionale) dhe zotërojnë aftësitë e nevojshme për vazhdimin në nivelin 5 të kualifikimit.

Kriteri 4. Nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion morëm informacion se ato vinin në përgjithësi nga gjimnazi ose shkollat profesionale teknike.

Kriteri 5. Programi i studimit TIE ka 120 ECTS por nuk lejon transferimin në vitin e tretë bachelor. Nga ky program studimi mund të bëhet transferimi i krediteve në sistemin Bachelor, Ligji 80/2015, neni 72, pika 2, ku sasia e krediteve të transferuara do të varet nga komisionet ad-hoc të ngritura në Universitete, ku studentët do të aplikojnë për programe Bachelor.

Kriteri 6. Balancimi praktikë/teori duhet të përmirësohet në drejtim të theksimit praktik me praktika profesionale, pasi anon më shumë nga ana teorike.

Kriteri 7. Në këtë program studimi vetëm 8.3% e programit të studimit (10/120 ECTS) janë punë konkrete në një semester: praktika profesionale.

Kriteri 8. Mësimi praktik dhe punës konkrete i është dhënë rreth 40% e orëve totale në auditor (546/1328). Duhet synuar që ky raport të shkojë minimum tek 50%.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit "Teknologji e instalimeve Elektrike" në Kolegjin Profesional të Tiranës është hartuar në përputhje me marrëveshjen e Bolonjës dhe bën pjesë në nivelin 5 të Kornizës Europiane të Kualifikimeve. Ky program studimi është fleksibël për t'iu përshtatur nevojave të tregut të punës. Në ecurinë e tij, këtij programi studimi është rritur aspekti praktik, duke rritur numrin e krediteve të praktikës megjithëse duhet që kjo punë të vazhdojë edhe më tej. Raporti praktikë/teori për orët e zhvilluara në auditor duhet të jetë të paktën 50/50.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia është një aspekt i rëndësishëm për punën e stafit akademik në KPT. Nga takimi me pedagogët dhe me studentët duke qartë që institucioni ka bërë përpjekje të mira për krijimin e kushteve optimale për kryerjen e mësimi dhe për mbështetjen me bazë materiale laboratorike të këtij programi studimi. Mësimdhënia organizohet në klasa të përshtatshme, me hapësirë, dritë, me ngrohje dhe të pajisura me mjete didaktike. Orari i mësimi për studentët është i përshtatshëm, i vijueshëm dhe afishohet në ambientet e KPT.

Nga ana e Departamentit që mbulon programin e studimit TIE, mësimdhënia organizohet në formën e leksioneve, ushtrimeve dhe punëve laboratorike. Gjithashtu në fund të programit të studimit zhvillohet një praktikë profesionale prej 6 javësh. Leksionet konsiderohen të rëndësishme për formimin teorik të studentëve, prandaj nga ana e departamentit kërkohet që në fund të çdo jave pedagogët të dorëzojnë në sekretarinë mësimore leksionet e shkruara e më pas iu jepen studentëve. Grupet e leksioneve nuk kanë më shumë se 70 vetë për lëndë që zhvillohen në disa programe studimi. Për lëndë karakteristike për një program studimi, ky numër është edhe më i vogël, pra nuk kemi mbingarkesë në klasa. Ushtrimet zhvillohen në grupe të vogla, në rastin konkret klasat janë me 15 dhe 7 studentë. Labororet zhvillohen në ambiente të dedikuara në shumicën e lëndëve, me 2-4 studentë për çdo post pune, në varësi nga lënda. Pedagogët e laboratorëve bëjnë si fillim instruktimin e studentëve me rregulloren e sigurimit teknik dhe me procedurën e punës laboratorike. Në ndihmë të studentëve jepen edhe relacionet teknike të tyre që merren në ambientet e KPT e më pas plotësohen prej tyre.

Ngarkesa e pedagogëve në mësimdhënie në këtë program studimi është brenda kufijve të lejuar. Pedagogët zhvillojnë përgjithsisht nga 1 ose 2 lëndë dhe rrallë me 3. Ky pohim bëhet mbi bazën e tabelës së planit mësimor lidhur me stafin akademik për këtë program studimi. Cilësia e mësimdhënies kontrollohet nga drejtuesi i departamentit e rektori, të cilët janë pedagogë me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie. Nga biseda me ta na u konfirmua se organizohen herë pas here orë mësimore me pjesmarrjen e tyre, me qëllim evidentimin e problematikës në mësimdhënie për pedagogët e rinj. Raportet për cilësinë e mësimdhënies hartohen nga NjSBC dhe u bëhen me dije pedagogëve.

Në KPT kontrolli i njohurive të studentëve është një proces që zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik e që përshkruhet në syllabuset e çdo lënde. Studenti kur futet në provimin përfundimtar të lëndës zotëron një sasi pikësh (më e shumta 40 pikë) që i ka grumbulluar mbi bazën e ndjekjes së lëndës në leksione e ushtrime, në laboratore e provimet gjatë semestrit. Vlerësimi për përvetësimin e njohurive bëhet me provimin përfundimtar, i cili quhet i fituar me minimum 41 pikë. Nga takimi me studentët u konfirmua se procedura e vlerësimit gjatë semestrit dhe e vlerësimit në provimin përfundimtar është transparente.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në KPT, që mbështet programin e studimit TIE nxit pedagogët të zhvillojnë metoda të ndryshme mësimdhënieje me qëllim rritjen e efektivitetit të saj në drejtim të mësimnxënjes. Në varësi nga karakteri i lëndës, leksionet zhvillohen duke kombinuar shkrimin në tabelë me prezantimin me POWERPOINT të skemave e diagramave teknike që nuk mund të riprodhohen saktësisht në tabelë. Në ushtrime pedagogët kombinojnë zgjidhjen në tabelë me simulimet në kompjuter. Në laboratore përdoret kombinimi i shpjegimeve teorike në lidhje me temën me punën praktike mbi modelet fizike objekt studimi ose me simulime në kompjuter. Në mbështetje të metodave të ndryshme të mësimdhënies nga ana e KPT janë bërë plotësime të vazhdueshme të auditorëve me projektorë, kompjuter me softë inxhinierike (Matlab, Multisim, Tina industrial etj) për pedagogët, kompjutera për studentët e mjete të tjera didaktike në funksion të mësimdhënies. Laboratorët janë të pasur dhe me tabela të bardha ku pedagogët bënin një shpjegim teorik përpara se të kryejnë puna laboratorike. Një praktikë e mirë në funksion të mësimdhënies është që KPT ka vënë në dispozicion 2 grupe portabël me nga 15 laptop secili, për pajisjen me kompjutera të klasave që nuk kanë kompjutera.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies është proces që bëhet sistematikisht, për të cilën angazhohen strukturat e ngritura nga institucioni, siç është NjSBC. Anketimet në çdo fund semestri analizohen nga NjSBC dhe problematika adresohet në departamentet përkatëse.

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Tabela 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 11

Programi i Studimit Jouniversitar 2 vjeçar Teknologjia e Instalimeve Elektrike	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	350
Seminare	-
Ushtrime	420
Laboratore	336
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	210
Tema/provim formimi	12
Në total	1328

Nga tabela vihet re se gjatë zhvillimit të programit studimit TIE, studenti zhvillon në auditor 770 orë me karakter teorik (leksione+ushtrime) dhe 546 orë me karakter praktik (laboratore+praktikë profesionale. Pra, raporti i orëve totale zhvilluar në auditor me karakter formim teorik / praktikë profesionale është 1/0.7, ose

orët mësimore me karakter praktik janë 41% e orëve totale të zhvilluara në auditor, ndërsa orët mësimore me karakter teorik janë 59% e orëve totale në auditor.

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 12

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)	30%
Testimet gjatë vitit	-
Provimi përfundimtar	60%
Etj	
Në total	100%

Gjatë vizitës në KPT në takimin e me stafin akademik, na u konfirmua se studentët vlerësohen mbi bazën e rezultateve në formën e pikëve të mbledhura prej pjesëmarrjes aktive e ndjekjes së lëndës, plotësimit të detyrimeve në punët laboratorike, detyra kursi, praktika profesionale si dhe provimi përfundimtar. E drejta për të dhënë provimin përfundimtar fitohet nga studenti që ka frekuentuar më shumë se 60% të leksioneve/ushtrimeve dhe më shumë se 80% të laboratoreve. Përpara provimit përfundimtar, studentët njoftohen prej pedagogut përkatës për sasinë e pikëve të fituara gjatë semestrit. Sasia maksimale e pikëve me të cilën një student mund të hyjë në provim është 40, ndërsa pikët minimale për të marrë notë kaluese janë 41. Kjo praktikë vlerësimi u konfirmua edhe prej studentëve.

Në fund të programit të studimit, në varësi të rezultateve të studentëve, diplomimi do bëhet me provim formimi. Provimi i formimit formulohet në një tezë me pyetje nga të gjitha lëndët, për të cilat përgjigjet kërkohen me shpjegime, pra me zhvillim dhe jo me alternativa, informacion i marrë nga vizita në institucion. Pas fitimit të provimit të formimit, studenti merr diplomën si “Teknik i lartë në teknologjinë e instalimeve elektrike” shoqëruar me listën e notave. Për këtë nivel kualifikimi (niveli 5) nuk parashikohet dhënia e suplementit të diplomës.

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Tabelën 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 13

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për projekte/praktika në rang Institucioni	9
Për punime individuale të pedagogëve	-
Për projekte /praktika në rang Departamenti	9
Për projekte në bashkëpunim me të tjerë	5

Shënim: Këto të dhëna i përkasin programeve të tjera të studimit. Nuk ka student të aktivizuar nga ky program studimi.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Studentët në KPT kanë kujdesin, vëmendjen dhe përkushtimin e gjithë instancave. Institucioni ka zhvilluar politika për tërheqjen e tyre, duke filluar me fushatën e rekrutimit të tyre nga gjimnazet dhe shkollat

profesionale në Tiranë e rrethe duke filluar nga muaji mars i çdo viti. Nga ana tjetër faqja zyrtare e KPT është e pajisur me informacion të bollshëm në lidhje me aktivitetet akademike e social kulturore të studentëve në KPT në vite, pra informacioni për mundësitë e regjistrimit në KPT janë të aksesueshme lehtësisht dhe të qarta për studentët e interesuar. Gjithashtu paraqitja me foto e ambienteve laboratorike dhe auditorëve është pjesë e politikës së KPT për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimit që KPT ofron.

KPT zhvillon një politikë efektive për tërheqjen e nxënësve me performancë të ulët drejt kolegjit profesional duke publikuar në faqen zyrtare të tij shembuj nga studentët e diplomuar të punësuar (në përputhje me diplomën e fituar në KPT) në kompani e subjekte të ndryshme.

Për pranimin e studentëve në KPT procedurat janë shumë të thjeshta e të hapura për çdo nxënës që ka diplomën e maturës shtetërore. Nota mesatare nuk përbën kufizim për pranimin në KPT. Gjithashtu asnjë lloj pengese tjetër për prejardhjen, moshën apo përkatësinë shoqërore nuk është vendosur nga KPT. Cilësia e studentëve në hyrje në programin e studimit TIE është e ulët, nëse i referohemi mesatares që kanë nga shkolla e mesme. Pjesa më e madhe e tyre ka mesatare 5-6.

Statistika për kohën mesatare të zgjatjes së studimeve, kalueshmërinë, punësimin, komunikimin me ish-studentë nuk ka, pasi ky program studimi nuk e ka ende brezin e parë të të diplomuarve.

- Procedurat e pranimit të studentëve, sipas informacionit të marrë në zyrën e Burimeve Njerëzore e Kontratave, janë të thjeshta e pa kufizime. Çdo nxënës që ka mbaruar maturën shtetërore, që depoziton : kartë ID fotokopje, çertifikatë familjare, diplomë e listë notash të maturës shtetërore, deklaratën e regjistrimit online, (pasi bën edhe pagesën) merr kontratën e studentit. Më pas për çdo student të regjistruar merret numri i matrikullimit nga Ministria e Arsimit. Në këtë zyrë u verifikuan dosjet e dy studentëve (të zgjedhura në mënyrë rastësore), të cilat rezultuan të plota.
- Kushte specifike të pranimit të studentëve në drejtim të kufizimit nuk ka. Tarifa e regjistrimit në këtë program studimi është 2200 EUR, por për të rritur cilësinë në hyrje të studentëve KPT ka hartuar një politikë pranime me tarifë të reduktuar si më poshtë:
 - Ka tarifë të reduktuar me 15% për studentët me mesatare >7
 - Ka tarifë të reduktuar me 30% për studentët me mesatare >8
 - Ka tarifë të reduktuar me 45% për studentët me mesatare >9
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (plotëso Tabelën 14, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 14

Programi i studimit 2 vjeçar jouniversitar në Teknologjia e Instalimeve Elektrike	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2017-2018	8	5-6	-	-
	3	6-7	-	-
	11	5-6	-	-
2018-2019	2	6-7	-	-
	1	7-8	-	-
	1	8-9	-	-
Në total	26		-	-

Nuk ka të dhëna për notën mesatare në dalje të studentëve sepse nuk ka ende studentë të diplomuar në këtë program studimi.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Në rregulloren e studimit parashikohet mobiliteti dhe transferimi i studimeve të studentëve që ndjekin këtë program studimi, neni 12.

- Të dhëna për punësimin e studentëve (plotëso tabelën 15 vetëm në rastin e riakreditimit)

Tabela 15

Periudha e të dhënave (2018-2019)			
Programi i studimit jouniversitar 2 vjeçar në Teknologjia e Instalimeve Elektrike	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
	-	-	-

Gjatë vizitës në KPT, u diskutua në lidhje me punësimin e studentëve në programet e tjera të studimit që mbulon Departamenti, pasi programi i studimit Teknologjia e instalimeve elektrike nuk e ka nxjerrë ende brezin e parë të të diplomuarve. Pas diplomimit, Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve, mban kontakt me studentët e diplomuar dhe informohet në lidhje me punësimin e tyre. E njëjta praktikë do të ndiqet edhe për studentët e diplomuar të këtij programi studimi që brezin e parë të të diplomuarve e ka në fund të vitit akademik 2018-2019.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Vlerësimi sipas standardeve:

<p>Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit</p> <p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibël për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.</p> <p>Kriteri 2 Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 3 Përmbajtja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësveve performancë të ulët</p> <p>Kriteri 5 Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.</p> <p><u>Vlerësimi sipas standardit 3:</u></p> <p>Kriteri 1. Programi i studimit TIE ka plan mësimor fleksibël për të mundësuar përshtatjen sa më të mirë me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 2. Program studimi është një program i ri studimi, në vitin e dytë të tij, dhe nuk ka studentë që ta kenë përfunduar atë.</p> <p>Kriteri 3. Përmbajtja e programit të studimit përfshin shumicën e aktiviteteve profesionale, për të cilat ka nevojë tregu i punës për këtë nivel kualifikimi.</p> <p>Kriteri 4. Nuk ka informacion për këtë kriter pasi është program i ri studimi, i cili nuk ka të diplomuarit e parë.</p> <p>Kriteri 5. Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme duke iu përshtatur nivelit të studentit me theksin tek puna konkrete në mjediset e laboratoreve, vizitave mësimore, si dhe praktika profesionale që do të zhvillohet jashtë institucionit dhe në ambientet e KPT.</p> <p>Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar</p>
--

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënësve është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit 4:

Kriteri 1. Nga vizita në institucion u vëzhgua se informacioni për mundësitë e regjistrimeve merret lehtësisht nga të gjithë të interesuarit, pasi KPT përveç faqes zyrtare të pasur me informacion ndërmerr edhe fushata rekrutimi të përvitshme në shkollat e mesme të vendit. Gjithashtu regjistrimet duke filluar nga viti 2017-2018 dhe në vazhdim kryhen nga faqja e u-albania dhe numrat e matikulimit gjenerohen dhe dërgohen nga MASR.

Kriteri 2. KPT nuk ka vendosur ende ura bashkëpunimi të mirëfillta me stafin e Arsimit dhe Formimit Profesional. (Reference dokumentat e vëna në dispozicion nga KPT dhe nga vizita në institucion)

Kriteri 3. Synimet e programit të studimit shprehen qartë në lidhje me pritshmëritë në formimin teorik dhe praktik të studentëve si dhe ka të publikuara disa shembuj të mirë të rezultateve të të mësuarit, nëpërmjet punësimit të të diplomuarve në programet e tjera të studimit, pasi për këtë program studimi nuk ka të diplomuar.

Kriteri 4. Bibloteka e KPT ka numër të vogël titujsh që janë kryesisht në shqip. Duhet të punohet për pasurimin e bibliotekës me manuale teknike të instalimeve elektrike. Institucioni ka ndërmarrë një projekt pilot për praktikën profesionale në institucion me qëllim orientimin e aftësisimit praktik në fusha ku operon biznesi i vogël (servise paisjesh elektroshtëpiake). Ky projekt është për programet e tjera të studimit.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit “Teknologjia e instalimeve elektrike” në KPT është hartuar në përputhje me kërkesat që ka tregu dhe është fleksibël në mënyrë që tu përshtatet kërkesave të tij. Njohuritë teorike ndërthuren me aftësimin praktik, por është e nevojshme që formimi praktik profesional të jetë më i spikatur, duke rritur numrin e orëve mësimore praktike në auditor, që raporti teori/praktikë të jetë minimumi 50/50.

Mësimdhënia përdor larmi formash për të arritur këtë qëllim.

Biblioteka duhet të pasurohet me manuale teknike të përshtatshme për këtë nivel programi studimi.

Procedurat e pranimit të studentëve janë të thjeshta dhe jokufizuese. Ato shoqërohen me politika lehtësuese në tarifat e regjistrimit për nxënësit me rezultate të mira, të përshkallëzuara sipas meritës.

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Në Kolegjin Profesional të Tiranës organizohen aktivitete me karakter profesional, ku marrin pjesë studentët dhe pedagogë me synimin që studentëve tu krijohet një ambient miqësor, bashkëpunues dhe nxitës. Në aktivitetet e organizuara nga palë të treta, marrin pjesë edhe studentët të KPT, të cilët favorizohen e nxitën të përfshihen në aktivitete në fusha të përbashkëta studimi me subjektet organizatore. Programi i Studimit “Teknologjia e Instalimeve Elektrike” është relativisht i ri, nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve të regjistruar, kështu që aktivitete të dedikuara për këtë program studimi nuk u evidentuan. Ky informacion ishte për programet e tjera të studimit.

KPT ka ndërmarrë iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve, duke i përfshirë ata në aktivitete si panairi “Work&Study”, i cili është një aktivitet i përvitshëm në dobi të punësimit të studentëve. Në këto panairë studentët mund të demonstrojnë aftësitë e tyre në përdorimin e pajisjeve laboratorike.

Një aktivitet me rëndësi për përmirësimin cilësor të stafit janë trajnimet nga POLYTECH, ku stafi akademik ka marrë trajnime të specializuara sipas lëndëve që mbulojnë në lidhje me pajisjet laboratorike që disponon KPT, për një përdorim sa më efektiv të tyre në dobi të mësimdhënies.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, janë evidencat me titull: Aktivitetet, Panairet, Trajnimet POLYTECH. Një pjesë e këtyre aktiviteteve pasqyrohen edhe në webfaqen zyrtare të KPT.

11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkimore

Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, Kolegji Profesional i Tiranës ka vendosur marrëdhënie institucionale afatgjata bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit, me punëdhënës ose biznese brenda vendit . Nga dokumentacioni i dosjes së vetvlerësimit shihet se KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL e tjera në vend si: me Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Europian të Tiranës dhe Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës për shkëmbim stafi në fushën e mësimdhënies.

KPT ka në vëmendje aftësimin profesional të studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi me kompaninë greke POLYTECH nga e cila KPT ka kryer furnizimin me pajisje laboratorike, ka kontribuar në aftësimin e pedagogëve për kryerjen e laboratoreve në funksion të programit të studimit. Ky bashkëpunim është dokumentuar në formë tabelore me të dhëna në lidhje me: lëndën, pedagogun dhe tematikat e trajnimit.

Bashkëpunimi i KPT me Verti Tech S.A, ka mundësuar trajnimin e stafit akademik e pedagogjik në përdorimin e sistemit Classter. Gjithashtu, në dobi të studentëve është bashkëpunimi me PROTIK për trajnimin e tyre në lidhje me printimet 3D. Këto trainime i përkasin programeve të tjera të studimit ofruar nga institucioni. KPT ka vendosur marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës së studentëve në varësi të natyrës specifike që ka programi i studimit. Gjatë vizitës në KPT pamë edhe formularin tip që kishte hartuar institucioni: "Formulari i vlerësimit të studentit praktikant". Në këtë formular ka informacion të plotë në lidhje me cilësinë e punës së studentit gjatë praktikës mësimore si dhe merret mendimi i personit të autorizuar për mbikqyrjen e praktikës nga subjekti pritës. Mendojmë që e njëjta procedurë do të ndiqet dhe për programin e TIE, pasi praktika mësimore për këtë program studimi do të zhvillohet për herë të parë në semestrin e dytë, viti 2019.

Për kryerjen e praktikave mësimore, KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani e biznese vendase të cilat i ofrojnë studentëve të KPT ambientet e tyre të punës në fushën e instalimeve elektrike në industri, instalimeve elektrike në banesa, në subjekte që merren me menaxhimin, mirëmbajtjen e energjisë elektrike etj. KPT- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, ka 11 marrëveshje bashkëpunimi pa afat me subjekte e kompani, nga të cilat 4 prej tyre kanë aktivitet të ngjashëm me fushën programit të të studimit "Teknologjia e instalimeve elektrike".

- Të dhënat për bashkëpunimin kombëtar për zhvillimin e praktikave mësimore i kemi vendosur në Tabelën 16, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës.

Tabela 16

Subjekti	Vendndodhja	Data e lidhjes së marrëveshjes	Afati i marrëveshjes	Fusha e aktivitetit
Impact shpk	Tiranë	15.05.2018	Pa afat	Instalime elektrike, elektronike
Eco Climate Solution	Tiranë	02.06.2017	Pa afat	Instalime elektrike
Birra Tirana	Tiranë	02.06.2017	Pa afat	Instalime elektrike
Balfin shpk	Tiranë	28.05.2018	Pa afat	

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar (dhe ndërkombëtar) (plotëso Tabelën 17, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 17

Aktivitete individuale ose në rang Institucioni, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar në vitet e fundit	
1	Trajnimi i stafit pedagogjik që mbulon programin e studimit TIE nga kompania POLYTECH që është edhe furnitorja kryesore e pajisjeve laboratorike.
2	Trajnim i stafit pedagogjik dhe administrativ për sistemin Classter nga Verti Tech S.A
3	Seminar nga PROTİK për studentë për printimet 3D
4	Projekti RYCO

ANALIZA SWOT

Analiza përmblledhëse sipas metodës SWOT (Strengths, Weaknesses-, Opportunities, Threats).

a. Pika të forta:

- Programi i studimit "Teknologjia e instalimeve elektrike" është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës.
- Institucioni KPT bën përpjekje serioze për plotësimin e nevojave të këtij programi studimi me laboratore e mjete të tjera didaktike.
- Institucioni zhvillon politika nxitëse për tërheqjen e një numri më të madh studentësh, duke promovuar shembujt e mirë të punësimit të të diplomuarve, fushatat e rekrutimit nëpër shkollat e mesme, tarifat e reduktuara për nxënësit me mesatare të lartë etj.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

- Ka pjesë të planit mësimor që nuk mbështeten mjaftueshëm me laboratore, kështu që KPT nevojitet të vazhdojë përpjekjet për plotësimin e tyre.
- Bibloteka e KPT duhet të pasurohet me tituj të rinj për programin e studimit "Teknologjia e instalimeve elektrike" dhe me manuale teknike profesionale të përshtatshme për këtë nivel kualifikimi.
- Syllabuset duhet të plotësohen me tematikat e laboratoreve (disa prej tyre) si dhe të rishikohet sasia e orëve mësimore që u jepet disa temave, në mënyrë që studenti të ketë kohën e mjaftueshme për asimilimin e njohurive.
- Ngarkesa mësimore mbahet kryesisht nga PAK kur duhet të jetë 70% nga PAE.

c. Mundësitë:

- Fuqizimi i laboratoreve dhe harmonizimi me praktikën profesionale të studentëve në institucion, mund të krijojë mundësira e përfitime në rritje.
- Pasurimi i syllabuseve me tematika me përfitim praktik e profesional, dhe zhveshja nga pjesa tradicionale e programeve të ngjashme të studimit në nivele më të larta kualifikimi, do ta bënte më tërheqës dhe më efektiv produktin në dalje.
- KPT duhet të të gjejë mënyra më efikase për promovimin e programit të studimit dhe tërheqjen e një numri më të madh studentësh dhe me kualitet më të lartë në hyrje.

d. Pengesat:

- Shumë nga lëndët bazë të formimit teorik e praktik, zhvillohen nga staf që kanë mbushur moshën e pensionit, rreth 40%, kështu që KPT duhet të tërheqë staf të ri të kualifikuar.
- Numri i vogël i studentëve të regjistruar e bën të vështirë realizimin e politikave afatmesme e afatgjata për zhvillimin e këtij programi studimi.
- Finacimi i programit të studimit vetëm prej tarifës së regjistrimit së studentëve është një pengesë në zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit.

Rekomandime:

1. Të shikohet mundësia e rekrutimit me staf të ri të kualifikuar dhe me ekspertizë në fushën e teknologjisë së instalimeve elektrike
2. Të shikohet mundësia e zhvillimit të praktikës mësimore në një semestër të plotë.

Gupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Dr. Aida Spahiu
2. Dr. Lindita Dharmo

SHTOJCA 1: Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK - marrë nga Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 “PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE”)

	Arsimi i Përgjithshëm	Arsimi Profesional	Formimi Profesional	
8	Doktoratë (Diplomë universitare për gradë shkencore)	Programe studimi / Kualifikim për specialist ekspert (Diplomë universitare për specializime apo kualifikime post master)		8
7	Programe studimi Master (Diplomë universitare)	Programe studimi / Kualifikime e Specializime për menaxherë të lartë dhe për specialistë të lartë (Diplomë universitare profesionale për kualifikime apo specializime post Bachelor)	Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përfitim ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë Profesionale).	7
6	Programe studimi Bachelor (Diplomë universitare)	Programe studimi profesionale Bachelor Kualifikime për menaxherë dhe për specialistë (Diplomë universitare)	Kurse për menaxherë, specialistë dhe teknikë të lartë sipas niveleve të “Arsimit Profesional” (Certifikatë Profesionale)	6
5	Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale)	Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm/Kualifikime për menaxherë të rinj dhe për teknikë të lartë deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale)		5
4	Matura e përgjithshme (Diplomë e Maturës Shtetërore) Programe studimi/Kurse kalimi (Dëftesë shkollore /certifikatë) Programe studimi/Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 3)	Matura profesionale (Diplomë e Maturës Shtetërore) Programe studimi/ Kurse kalimi (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale) Kualifikime për mbikëqyrës dhe për teknikë (Certifikatë)	Kurse kalimi (Certifikatë) Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përfitim ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë kompetencash dhe Certifikatë për mbikëqyrës dhe teknikë)	4
3	Programe studimi deri dy vjet në arsimin e mesëm/ Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 2)	Programe studimi/Trajnimi deri dy vjet për punëtor të kualifikuar (Dëftesa shkollore / Certifikatë profesionale)	Kurse për punëtor të kualifikuar (Certifikatë për punëtor të kualifikuar)	3
2	Programe studimi 1 vit në arsimin e mesëm / Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 1)	Program studimi/trajnimi 1 vit, për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale)	Kurse Formimi/Trajnimi për ndihmës dhe punëtor gjysmë të kualifikuar (Certifikatë për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar)	2
1	KUALIFIKIMET MINIMALE PËR HYRJE NË PUNË OSE JETË SHOQËRORE (Dëftesë Lirimi)			1

SHTOJCA 2

	Njohuri	Aftësi	Kompetenca
Niveli 1	Njohuri bazë të përgjithshme	Aftësi bazë të nevojshme për kryerjen e detyrave të thjeshta	Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë brenda një kuadri të strukturuar
Niveli 2	Njohuri bazë faktike për një fushë pune ose studimi	Aftësi bazë njohëse dhe praktike për përdorimin e informacionit përkatës, me qëllim kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve rutinë, duke përdorur rregulla dhe mjete të thjeshta.	Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje, me pavarësi të caktuar
Niveli 3	Njohuri mbi faktet, parimet, proceset dhe konceptet e përgjithshme në një fushë pune ose studimi	Një sere aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për përmbushjen e detyrave dhe për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet përzgjedhjes dhe për zbatimin e metodave, mjeteve, materialeve dhe informacionit bazë	Marrje e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave në punë e studim. Përshtatje në rrethana të caktuara për zgjidhjen e problemeve
Niveli 4	Njohuri teorike e faktike në një kontekst të gjerë në një fushë pune ose studimi	Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur probleme të veçanta në një fushë pune ose studimi	Vetëmenaxhim brenda kuadrit udhëzues të punës ose studimit, i cili zakonisht është i parashikuar, por mund të ndryshohet. Mbikëqyrje e punës rutinë të tjerëve, duke marrë disa përgjegjësi për vlerësimin dhe përmirësimin e veprimtarive të punës ose studimit
Niveli 5	Njohuri gjithëpërfshirëse të specializuara faktike dhe teorike brenda një fushe pune apo studimi deri në një nivel të caktuar	Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet	Menaxhim dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive të punës ose studimit, në situata të ndryshueshme. Shqyrtimi dhe përmirësimi i performancës vetjake dhe të tjerëve
Niveli 6	Njohuri të avancuara në një fushë pune apo studimi, duke përfshirë analizën kritike të teorive dhe parimeve	Aftësi të avancuara, që tregojnë mjeshtëri dhe inovacion, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë pune ose studimi	Menaxhim i veprimtarive ose projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke marrë përgjegjësi për vendimmarrje në një situatë të paparashikuar pune apo studimi. Marrje përgjegjësi për menaxhimin dhe zhvillimin profesional të individëve apo të grupeve
	Njohuri shumë të specializuara, disa prej të cilave në nivel të avancuar bashkëkohor në një fushë pune ose studimi, si bazë për mendim dhe kërkim origjinal. Analizë kritike e dijeve në një fushë ose në ndërveprimin e fushave të ndryshme	Aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve që nevojiten për kërkim dhe /ose inovacione, me qëllim që të zhvillojë njohuri dhe procedura të reja si dhe të integrojë njohuri nga fusha të ndryshme	Menaxhim dhe transformim i konteksteve të punës dhe studimit që janë komplekse, të paparashikueshme dhe që kërkojnë përqasje të reja strategjike.
Niveli 7			Marrje përgjegjësie për të kontribuar në njohuri ose praktikë profesionale dhe/ose për të rishikuar performancën strategjike të stafit/grupit.

<p>Niveli 8</p>	<p>Njohuri në nivelin më të avancuar të një fushe pune apo studimi, si dhe në ndërveprimin ndërmjet fushave</p>	<p>Aftësi dhe teknika tepër të avancuara dhe të specializuara që përfshijnë sinteza dhe vlerësime të nevojshme për zgjidhjen e problemeve kritike në kërkim dhe/ose inovacion, si dhe zgjerimin dhe ripërcaktimin e njohurive ose praktikave profesionale ekzistuese.</p>	<p>Të demonstrojë autoritet të plotë, inovacion, pavarësi, integritet studimor dhe profesional, përkushtim të vazhdueshëm për të zhvilluar ide dhe procese të reja në kontekstin më të avancuar të punës ose studimit, përfshirë dhe kërkimin</p>
------------------------	---	---	---

Përgjigje mbi komentet e bëra nga KPT për draft raportin e vlerësimit të jashtëm

Më poshtë po japim në mënyrë të detajuar të gjitha përgjigjet mbi komentet e bëra nga KPT

1. Vërejtja 1 e sugjeruar nga KPT është marrë parasysh dhe reflektuar në raport
2. Vërejtja 2 mbetet siç është pasi është thjesht konstatim
3. Vërejtja 3 e KPT është marrë parasysh dhe reflektuar në raport.
4. Vërejtja 4 e KPT mbetet siç është në raport.
5. Vërejtja 5 e KPT mbetet siç është në raport.
6. Vërejtja 6 e KPT është marrë parasysh në raport dhe është riformuluar.
7. Vërejtja 7 e KPT mbetet siç është në raport.
8. Vërejtja 8 e KPT mbetet siç është në raport.
9. Vërejtja 9 e KPT mbetet siç është në raport.
10. Vërejtja 10 e KPT merret parasysh.
11. Vërejtja 11 e KPT merret parasysh.
12. Vërejtja 12 e KPT merret parasysh vetëm pjesa e parë, e cila është riformuluar.
13. Vërejtja 13 e KPT merret parasysh.
14. Vërejtja 14 e KPT mbetet siç është në raport.
15. Vërejtja 15 e KPT mbetet siç është në raport.
16. Vërejtja 16 e KPT merret parasysh duke u riformuluar.
17. Vërejtja 17 e KPT merret parasysh.
18. Vërejtja 18 e KPT mbetet siç është në raport.
19. Vërejtja 19 e KPT, sqarojmë që është thënë në konotacion pozitiv, dhe është riformuluar për t'u shprehur më qartë.
20. Vërejtja 20 e KPT mbetet siç është në raport.
21. Vërejtja 21 e KPT është marrë parasysh pjesërisht dhe është riformuluar.
22. Vërejtja 22 e KPT mbetet siç është në raport, pasi është thjesht një sugjerim.
23. Vërejtja 23 e KPT mbetet siç është në raport.
24. Vërejtja 24 e KPT mbetet siç është në raport.
25. Vërejtja 25 e KPT mbetet siç është në raport.
26. Vërejtja 26 e KPT riformulohet sipas sugjerimit të bërë.